




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

KRYETARI I KOMUNËS
Presednik Opštine – Municipal Mayor

**LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT,
Z. SMAJL LATIFI**

NGA DATA 01.07.2025 DERI MË 04.07.2025

NR.	EMRI I VENDIMIT	NR. I PROTOKOLLIT
1.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).	NRP-02-6253-2025
2.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).	NRP-02-6254-2025
3.	Vendim për ndërprerjen e kontratës me titull : “Rregullimi i varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe civilëve”	NRP-02-6258-2025
4.	Vendim për emërimin e përkohshëm të drejtorit të ShFMU “Sakip Bellaqa” në Pataqan të Epërm.	NRP-02-6264-2025
5.	Vendim për emërimin e përkohshëm të drejtorit të ShFMU “Nesemi Elshani” në Nagavc.	NRP-02-6265-2025
6.	Vendim për emërimin e përkohshëm të drejtorit të ShFMU “Milaim Krasniqi” në Pastasel.	NRP-02-6266-2025
7.	Vendim për emërimin e përkohshëm të drejtorit të ShFMU “Lidhja e Prizrenit” në Opterushë.	NRP-02-6267-2025
8.	Vendim për emërimin e përkohshëm të drejtorit të ShFMU “Faik Konica” në Celinë.	NRP-02-6268-2025
10.	Vendim për emërimin e përkohshëm të drejtorit të ShFMU “Bekim Sylka” në Rahovec.	NRP-02-6269-2025
11.	Vendim për emërimin e përkohshëm të drejtorit të çerdhes së fëmijëve “Tulipanët” në Rahovec.	NRP-02-6270-2025
12.	Vendim për emërimin e përkohshëm të drejtorit të ShFMU “Gëzim Hamza- Piktori” në Rahovec	NRP-02-6271-2025
13.	Vendim për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: " Ndërtimi i parkingjeve të reja me ndriçim	NRP-02-6272-2025

	publik hapësira të gjelbëruara dhe ndërtimi i rrugës në lagjen e komuniteteve"	
14.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës "Furnizimi dhe rregullimi i xhamave në shkolla-Ritenderim"	NRP-02-6275-2025



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0022833/25, e dt. 23.06.2025 për ndihmë financiare prej 500.00€ (pesëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Znj. [redacted] nga Rahoveci me datë 26.06.2025 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehonin (lindje) pasi që me datë 19.06.2025 ka lindur **Djal** në QKMF “Dr. Fahredin Hoti” në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për znj. [redacted] si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi


Me vendim të njoftohen:

- Znj. [redacted] nga Rahoveci,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0023132/25, e dt. 25.06.2025 për ndihmë financiare prej 500.00€ (pesëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Znj. [redacted] nga Rahoveci me datë 25.06.2025 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehoni (lindje) pasi që me datë 18.06.2025 ka lindur **Djal** në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për znj. [redacted] dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- Znj. [redacted] nga Rahoveci,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6258 Nr. i faq/Br.str/No.pg 128

Data/Datum/Date 01 / 07 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 72 të Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, rekomandimit dhe kërkesës me Nr. Prot. 2239 të datës 1.7.2025 të menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës me titull: “Rregullimi i varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe civilëve” me nr. të prokurimit 623-24-493-5-2-1/C555, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndërprerjen e kontratës me titull: “Rregullimi i varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe civilëve”

1. **Miratohet** kërkesa e menaxherit të projektit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës për ndërprerjen e kontratës me titull: “Rregullimi i varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe civilëve” me nr. të prokurimit 623-24-493-5-2-1/C555.
2. Ndërprerja e kontratës sipas pikës 1 të këtij vendimi bëhet për shkak të mosvazhdimit të punimeve nga ana e operatorit ekonomik.
3. Obligohet Zyra e Prokurimit që t’i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme konform dispozitave ligjore në fuqi për ndërprerjen e kontratës sipas pikës 1 të këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komuna e Rahovecit (në vazhdim “autoriteti kontraktues”) në njërën anë dhe grupi i operatorëve ekonomikë, Milazim S. Shala; “Tosi – V” SH.P.K., me seli në Prizren (në vazhdim “kontraktuesi”) në anën tjetër, kanë nënshkruar kontratën me titull: “Rregullimi i varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe civilëve”, me nr. të prokurimit 623-24-493-5-2-1/C555, me nr. prot. 729, të datës 5.3.2024.

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate, operatori ekonomik ka filluar punët në terren me qëllim të rregullimit të varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe civilëve në bazë të planit të punës dhe planit dinamik të punës të aprovuar nga ana e operatorit ekonomik dhe menaxherit të kontratës dhe atë vetëm deri më datë 29 prill 2025, kur është kryer punimi i fundit në terren nga operatori ekonomik.

Edhe përkundër faktit që kushtet atmosferike për punët në terren kanë qenë adekuate, që nga kjo datë, respektivisht që nga data 29 prill 2025, operatori ekonomik nuk ka vazhduar punimet në terren për realizimin e planit dinamik të kontratës, ashtu siç është dakorduar.

Pas kësaj, menaxheri i kontratës, me emailin e datës 10 qershor, i ka kërkuar operatorit ekonomik që të vazhdojë me punimet për realizimin e punëve të parapara në planin dinamik, pasi kushtet atmosferike janë përmirësuar, i njëjti nuk i është përgjigjur pozitivisht dhe nuk ka filluar punimet.

Provë: emaili i datës 3 qershor 2025.

Më datë 10 qershor, menaxheri i kontratës i është drejtuar përsëri me email operatorit ekonomik, ku përsëri i ka kërkuar që të fillojë punimet në Gradish jo më larg se deri më datë 12 qershor 2025.

Provë: emaili i datës 10 qershor 2025.

Më datë 30 qershor, menaxheri i kontratës përmes emailit i ka kërkuar operatorit ekonomik përsëri vazhdimin e punimeve në realizimin e planit dinamik të kësaj kontrate, por prapë nuk është marrë asnjë përgjigje nga ana e operatorit ekonomik.

Provë: emaili i datës 30 qershor 2025.

Pas kërkesave të vazhdueshme nga menaxheri i kontratës në drejtim të operatorit ekonomik për vazhdimin e punimeve për përmbushjen e kontratës së cekur në nenin 1 të këtij vendimi, menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës ka parashtruar rekomandim dhe kërkesë te Zyrtari Kryesor Administrativ, me nr. prot. 2239, të datës 1.7.2025, me të cilën ka kërkuar ndërprerjen (shkëputjen) e kontratës me titull: “Rregullimi i varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe civilëve”, me nr. të prokurimit 623-24-493-5-2-1/C555.

Andaj, duke u bazuar në rekomandimin dhe kërkesën me nr. prot. 2239, të datës 1.7.2025 të menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, si dhe duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 36.1 dhe 36.2 shkronja b), lidhur me nenin 37 të Kontratës me nr. prot. 729, të datës 5.3.2024, me titull: “Rregullimi i varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe civilëve”, me nr. të prokurimit 623-24-493-5-2-1/C555, është konstatuar se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për ndërprerjen (shkëputjen) e kësaj kontrate.

Nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të tij, në Autoritetin Kontraktues.

Me vendim të njoftohen:

- **Milazim S. Shala; “Tosi – V” SH.P.K. me seli në Prizren,**
- **Zyra e Prokurimi,**
- **Menaxheri i projektit, dhe**
- **Arkivi.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6264 Nr. i faq./Br.str./No.pg 129
Data/Datum/Date 02 / 07 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), neni 38 i Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 17/2011"), neni 18 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesionalë, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar dhe nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e përkohshëm të drejtorit të ShFMU "Sakip Bellaqa" në Pataqan të Epërm

1. Avdullah Bellaqa nga fshati Pataqan i Epërm, komuna e Rahovecit, **EMËROHET** përkohësisht drejtor në ShFMU "Sakip Bellaqa" në Pataqan të Epërm.
2. I lartpërmenduri sipas pikës 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht drejtor në ShFMU "Sakip Bellaqa" në Pataqan të Epërm, nga data 2.7.2025 deri në përfundimin e procedurave të konkursit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës së këtij institucioni arsimor.
3. Të lartpërmendurit në pikën 1 të këtij vendimi i takon kompensimi i pagës së drejtorit/eshës së ShFMU-së deri në përfundim të emërimit të përkohshëm.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh që më datë 1.7.2025, përfundon kontrata e punës e drejtorit të ShFMU "Sakip Bellaqa" në Pataqan të Epërm, Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit ka parashtruar kërkesë për emërimin e përkohshëm të drejtorit në ShFMU "Sakip Bellaqa" në Pataqan të Epërm.

Pas shqyrtimit të kërkesës së Drejtorisë për Arsim, duke u bazuar në nenin 18 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesionalë, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Avdullah Bellaqa nga fshati Pataqan i Epërm, emërohet përkohësisht drejtor në ShFMU "Sakip Bellaqa" në Pataqan të Epërm.

I lartpërmenduri emërohet përkohësisht drejtor në ShFMU “Sakip Bellaqa” në Pataqan të Epërm nga data 2.7.2025 deri në përfundimin e procedurave të konkursit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës së këtij institucioni arsimor.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa në kuadër të komunës së Rahovecit.

Me vendim të njoftohen:

- *Avdullah Bellaqa nga fsh. Pataqan i Epërm,*
- *Drejtoria për Arsim,*
- *Njësia e Personelit, dhe*
- *Arkivi.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / RE
OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6265 Nr. i faq./Br.str/No.pg 129

Data/Datum/Date 02 / 07 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), neni 38 i Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 17/2011"), neni 18 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesionalë, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar dhe nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e përkohshëm të drejtorit të ShFMU "Nesemi Elshani" në Nagavc

1. Nasip Krasniqi nga fshati Nagavc, komuna e Rahovecit, **EMËROHET** përkohësisht drejtor në ShFMU "Nesemi Elshani" në Nagavc.
2. I lartpërmenduri sipas pikës 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht drejtor në ShFMU "Nesemi Elshani" në Nagavc, nga data 2.7.2025 deri në përfundimin e procedurave të konkursit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës së këtij institucioni arsimor.
3. Të lartpërmendurit në pikën 1 të këtij vendimi i takon kompensimi i pagës së drejtorit/eshës së ShFMU-së deri në përfundim të emërimit të përkohshëm.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh që më datë 1.7.2025, përfundon kontrata e punës e drejtorit të ShFMU "Nesemi Elshani" në Nagavc, Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit ka parashtruar kërkesë për emërimin e përkohshëm të drejtorit në ShFMU "Nesemi Elshani" në Nagavc.

Pas shqyrtimit të kërkesës së Drejtorisë për Arsim, duke u bazuar në nenin 18 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesionalë, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Nasip Krasniqi nga fshati Nagavc, emërohet përkohësisht drejtor në ShFMU "Nesemi Elshani" në Nagavc.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa në kuadër të komunës së Rahovecit.

- *Nasip Krasniqi nga fsh. Nagavc,*
- *Drejtoria për Arsim,*
- *Njësia e Personelit, dhe*
- *Arkivi.*

2



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), neni 38 i Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 17/2011”), neni 18 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesionalë, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar dhe neni 74 dhe neni 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e përkohshëm të drejtorit të ShFMU “Milaim Krasniqi” në Pastasel

1. Destan Krasniqi nga fshati Pastasel, komuna e Rahovecit, **EMËROHET** përkohësisht drejtor në ShFMU “Milaim Krasniqi” në Pastasel.
2. I lartpërmenduri sipas pikës 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht drejtor në ShFMU “Milaim Krasniqi” në Pastasel, nga data 2.7.2025 deri në përfundimin e procedurave të konkursit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës së këtij institucioni arsimor.
3. Të lartpërmendurit në pikën 1 të këtij vendimi i takon kompensimi i pagës së drejtorit/eshës së ShFMU-së deri në përfundim të emërimit të përkohshëm.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit.

Arsyetim

Duke marrë parasysh që më datë 1.7.2025, përfundon kontrata e punës e drejtorit të ShFMU “Milaim Krasniqi” në Pastasel, Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit ka parashtruar kërkesë për emërimin e përkohshëm të drejtorit në ShFMU “Milaim Krasniqi” në Pastasel.

Pas shqyrtimit të kërkesës së Drejtorisë për Arsim, duke u bazuar në nenin 18 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesionalë, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Destan Krasniqi nga fshati Pastasel, emërohet përkohësisht drejtor në ShFMU “Milaim Krasniqi” në Pastasel.

I lartpërmenduri emërohet përkohësisht drejtor në ShFMU “Milaim Krasniqi” në Pastasel, nga data 2.7.2025 deri në përfundimin e procedurave të konkursit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës së këtij institucioni arsimor.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të vendimit në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa në kuadër të komunës së Rahovecit.

Me vendim të njoftohen:

- *Destan Krasniqi nga fsh. Pastasel,*
- *Drejtoria për Arsim,*
- *Njësia e Personelit, dhe*
- *Arkivi.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6267 Nr. i faq./Br.str./No.pg 129
Data/Datum/Date 02 / 07 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), neni 38 i Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 17/2011”), neni 18 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesionalë, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar dhe neni 74 dhe neni 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e përkohshëm të drejtorit të ShFMU “Lidhja e Prizrenit” në Opterushë

1. Skënder Krasniqi nga fshati Opterushë, komuna e Rahovecit, **EMËROHET** përkohësisht drejtor në ShFMU “Lidhja e Prizrenit” në Opterushë.
2. I lartpërmenduri sipas pikës 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht drejtor në ShFMU “Lidhja e Prizrenit” në Opterushë, nga data: 2.7.2025 deri në përfundimin e procedurave të konkursit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës së këtij institucioni arsimor.
3. Të lartpërmendurit në pikën 1 të këtij vendimi i takon kompensimi i pagës së drejtorit/eshës së ShFMU-së deri në përfundim të emërimit të përkohshëm.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit.

Arsyetim

Duke marrë parasysh që më datë 1.7.2025, përfundon kontrata e punës e drejtorit të ShFMU “Lidhja e Prizrenit” në Opterushë, Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit ka parashtruar kërkesë për emërimin e përkohshëm të drejtorit në ShFMU “Lidhja e Prizrenit” në Opterushë.

Pas shqyrtimit të kërkesës së Drejtorisë për Arsim, duke u bazuar në nenin 18 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesionalë, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Skënder Krasniqi nga fshati Opterushë, emërohet përkohësisht drejtor në ShFMU “Lidhja e Prizrenit” në Opterushë.

I lartpërmenduri emërohet përkohësisht drejtor në ShFMU "Lidhja e Prizrenit" në Opterushë, nga data 2.7.2025 deri në përfundimin e procedurave të konkursit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës së këtij institucioni arsimor.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimet të vendimit në Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa në kuadër të komunës së Rahovecit.

Me vendim të njoftohen:

- *Skënder Krasniqi nga fsh. Opterushë,*
- *Drejtoria për Arsim,*
- *Njësia e Personelit, dhe*
- *Arkivi.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Nëseja Nr./Br./No. 02/Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No. 6268 Nr. i faq./Br.str./No.pg. 129

Date/Datum/Date 02 / 07 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), neni 38 i Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 17/2011”), nenit 18 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesionalë, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar dhe nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e përkohshëm të drejtorit të ShFMU “Faik Konica” në Celinë

1. Ymer Fazliu nga fshati Celinë, komuna e Rahovecit, **EMËROHET** përkohësisht drejtor në ShFMU “Faik Konica” në Celinë.
2. I lartpërmenduri sipas pikës 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht drejtor në ShFMU “Faik Konica” në Celinë, nga data 2.7.2025 deri në përfundimin e procedurave të konkursit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës së këtij institucioni arsimor.
3. Të lartpërmendurit në pikën 1 të këtij vendimi i takon kompensimi i pagës së drejtorit/eshës së ShFMU-së deri në përfundim të emërimit të përkohshëm.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit.

Arsyetim

Duke marrë parasysh që më datë 1.7.2025 i përfundon kontrata e punës e drejtorit të ShFMU “Faik Konica” në Celinë, Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit, ka parashtruar kërkesë për emërimin e përkohshëm të drejtorit në ShFMU “Faik Konica” në Celinë.

Pas shqyrtimit të kërkesës së Drejtorisë për Arsim, duke u bazuar në nenin 18 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesionalë, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Ymer Fazliu nga fshati Celinë, emërohet përkohësisht drejtor në ShFMU “Faik Konica” në Celinë.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa në kuadër të komunës së Rahovecit.

- *Ymer Fazliu nga fshati Celinë,*
- *Drejtoria për Arsim,*
- *Njësia e Personelit, dhe*
- *Arkivi.*

2



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6265 Nr. i faq./Br.str./No.pg 125
Data/Datum/Date 02 / 07 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), neni 38 i Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 17/2011”), neni 18 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesionalë, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar dhe nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e përkohshëm të drejtoreshës së ShFMU “Bekim Sylka” në Rahovec

1. Beatrisa Pista-Demiri nga Rahoveci, **EMËROHET** përkohësisht drejtoreshë në ShFMU “Bekim Sylka” në Rahovec.
2. E lartpërmendura sipas pikës 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht drejtoreshë në ShFMU “Bekim Sylka” në Rahovec, nga data 2.7.2025 deri në përfundimin e procedurave të konkursit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës së këtij institucioni arsimor.
3. Të lartpërmendurës në pikën 1 të këtij vendimi i takon kompensimi i pagës së drejtorit/eshës së ShFMU-së deri në përfundim të emërimit të përkohshëm.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh që më datë 1.7.2025 përfundon kontrata e punës e drejtorit të ShFMU “Bekim Sylka” në Rahovec, Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit, ka parashtruar kërkesë për emërimin e përkohshëm të drejtoreshës në ShFMU “Bekim Sylka” në Rahovec.

Pas shqyrtimit të kërkesës së Drejtorisë për Arsim, duke u bazuar në nenin 18 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesionalë, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Beatrisa Pista-Demiri nga Rahoveci, emërohet përkohësisht drejtoreshë në ShFMU “Bekim Sylka” në Rahovec.

E lartpërmendura emërohet përkohësisht drejtoreshë në ShFMU “Bekim Sylka” në Rahovec nga data 2.7.2025 deri në përfundimin e procedurave të konkursit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës së këtij institucioni arsimor.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit në Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa në kuadër të komunës së Rahovecit.

Me vendim të njoftohen:

- *Beatrisa Pista-Demiri nga Rahoveci,*
- *Drejtoria për Arsim,*
- *Njësia e Personelit, dhe*
- *Arkivi.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No. 6270 Nr. i faq./Br.str./No.pg. 129

Data/Datum/Date 02 / 07 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), neni 38 i Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 17/2011”), neni 18 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesionalë, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar dhe neni 74 dhe neni 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e përkohshëm të drejtoreshës së çerdhes së fëmijëve “Tulipanët” në Rahovec

1. Brikena Osa nga Rahoveci, **EMËROHET** përkohësisht drejtoreshë në çerdhen e fëmijëve “Tulipanët” në Rahovec.
2. E lartpërmendura sipas pikës 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht drejtoreshë në çerdhen e fëmijëve “Tulipanët” në Rahovec, nga data 2.7.2025 deri në përfundimin e procedurave të konkursit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës së këtij institucioni arsimor.
3. Të lartpërmendurës në pikën 1 të këtij vendimi i takon kompensimi i pagës së drejtorit/eshës së ShFMU-së deri në përfundim të emërimit të përkohshëm.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh që më datë 1.7.2025 i përfundon kontrata e punës e drejtorit të çerdhes së fëmijëve “Tulipanët” në Rahovec, Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit, ka parashtruar kërkesë për emërimin e përkohshëm të drejtoreshës në çerdhen e fëmijëve “Tulipanët” në Rahovec.

Pas shqyrtimit të kërkesës së Drejtorisë për Arsim, duke u bazuar në nenin 18 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesionalë, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Brikena Osa nga Rahoveci, emërohet përkohësisht drejtoreshë në çerdhen e fëmijëve “Tulipanët” në Rahovec.

E lartpërmendura emërohet përkohësisht drejtoreshë në çerdhen e fëmijëve “Tulipanët” në Rahovec nga data 2.7.2025 deri në përfundimin e procedurave të konkursit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës së këtij institucioni arsimor.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të vendimit në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa në kuadër të komunës së Rahovecit.

Me vendim të njoftohen:

- **Brikena Osa nga Rahoveci,**
- **Drejtoria për Arsim,**
- **Njësia e Personelit, dhe**
- **Arkivi.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njesia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6271 Nr. i faq./Br.str./No.pg 130

Data/Datum/Date 02 / 07 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), neni 38 i Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 17/2011”), neni 18 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesionalë, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar dhe nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e përkohshëm të drejtorit të ShFMU “Gëzim Hamza - Piktori” në Rahovec

1. Enis Berisha nga Rahoveci, **EMËROHET** përkohësisht drejtor në ShFMU “Gëzim Hamza - Piktori” në Rahovec.
2. I lartpërmenduri sipas pikës 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht drejtor në ShFMU “Gëzim Hamza – Piktori” në Rahovec, nga data 2.7.2025 deri në përfundimin e procedurave të konkursit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës së këtij institucioni arsimor.
3. Të lartpërmendurit në pikën 1 të këtij vendimi i takon kompensimi i pagës së drejtorit/eshës së ShFMU-së deri në përfundim të emërimit të përkohshëm.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit.

Arsyetim

Duke marrë parasysh që më datë 1.7.2025, përfundon kontrata e punës e drejtorit të ShFMU “Gëzim Hamza – Piktori” në Rahovec, Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit ka parashtruar kërkesë për emërimin e përkohshëm të drejtorit në ShFMU “Gëzim Hamza – Piktori” në Rahovec.

Pas shqyrtimit të kërkesës së Drejtorisë për Arsim, duke u bazuar në nenin 18 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesionalë, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Enis Berisha nga Rahoveci, emërohet përkohësisht drejtor në ShFMU “Gëzim Hamza - Piktori” në Rahovec.

I lartpërmenduri emërohet përkohësisht drejtor në ShFMU “Gëzim Hamza – Piktori” në Rahovec nga data 2.7.2025 deri në përfundimin e procedurave të konkursit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës së këtij institucioni arsimor.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa në kuadër të komunës së Rahovecit.

Me vendim të njoftohen:

- *Enis Berisha nga Rahoveci,*
- *Drejtoria për Arsim,*
- *Njësia e Personelit, dhe*
- *Arkivi.*






Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 28 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011"), nenit 19 paragrafi 19.16 i Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i parkingjeve të reja me ndriçim publik, hapësira të gjelbëruara dhe ndërtimi i rrugës në lagjen e komuniteteve"

1. Proing & Partners Sh.P.K., **emërohet** person përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i parkingjeve të reja me ndriçim publik, hapësira të gjelbëruara dhe ndërtimi i rrugës në lagjen e komuniteteve".
2. Personi përgjegjës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, ka për detyrë që të bëjë hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik dhe Rregulloren Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.
3. Përgjegjësitë e personit për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, janë:
 - 3.1. Në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomikë, në përputhje me nenin 28 Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe akteve nënligjore (legjislacionit dytësor);
 - 3.2. Në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomikë;
 - 3.3. Të cilat nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, një procesi të hollësishëm, ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë, ose ndonjë prodhimi.

4. Personi përgjegjës obligohet që të hartojë specifikimet teknike / termat e referencës deri më datë 4.7.2025.
5. Personi përgjegjës obligohet që, së bashku me specifikimet teknike / termat e referencës, të dorëzojë edhe deklaratën në betim, të nënshkruar te Njësia e Prokurimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- ***Proing & Partners Sh.P.K.,***
- ***Drejtoria për Shërbime Publike,***
- ***Njësia e Prokurimit, dhe***
- ***Arkivi.***





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA OF KOSOVO	
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI PËR Kryetarin / Kabinets for the Mayor	
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)	
Nr./Br./No	6275 Nr. i faq./Br.str./No.pg 130
Data/Datum/Date	03 / 07 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC	

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjës të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: **“Furnizimi dhe rregullimi i xhamave në shkolla – Ritenderim”**, me numër të kontratës: **623-25-4659-1-3-6/C679**, si në vijim:
 - 1.1. Admirim Durguti, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar për paga dhe shpenzime pranë Drejtorisë për Arsim, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. Avni Morina, drejtor i Drejtorisë për Arsim, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxherit të Kontratës.
3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
 - 3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;
 - 3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë; dhe
 - 3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.
4. Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
 - 4.1. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimi të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës

nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";

- 4.2. Menaxheri i kontratës, duhet të lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;
- 4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërblërjen;
- 4.4. Pas pranimi të urdhërblërjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërblërjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
- 4.5. Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- 4.6. Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- 4.7. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- 4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;
- 4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
- 4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;
- 4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- 4.12. T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
- 4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimi të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;
- 4.14. T'i japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe
- 4.15. T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.

5. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:

- 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe
- 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- *Menaxheri i kontratës,*
- *Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,*
- *Spektori i Prokurimit, dhe*
- *Arkivi.*

